

DEKLARATË

Falënderojmë Presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kongresin, Departamentin e Shtetit e të Mbrojtjes dhe u shprehim mirënjohjen tonë për projektligjin (HR 987 PCS dhe S 494 ES), me anën e të cilit Shtetet e Bashkuara mbështesin zgjerimin e mëtejshëm të NATO-s dhe bëjnë thirrje për pranimin e Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut (bashkë me katër vende të tjera: Kroacinë, Maqedoninë, Gjeorgjinë dhe Ukrainën), duke i ofruar ftesën e pranimit në Samitin e NATO-s të vitit 2008.

Vendi ynë, si pjesë e natyrshme e Europës, ndan me Komunitetin Euroatlantik vlerat e përbashkëta të lirisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit, vlera, të cilat i mbrojmë dhe i forcojmë bashkërisht, në të mirën tonë, të rajonit dhe më gjerë.

Në muajt në vazhdim do të përkrahim të gjitha reformat dhe përpjekjet për plotësimin e objektivave të Planit të Veprimit për Anëtarësim, reformat për forcimin e shtetit të së drejtës, për thellimin e luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit, si dhe për forcimin e demokracisë në vend.

Ne do të vazhdojmë të mbështesim pjesëmarrjen dhe rritjen e kontributit të vendit tonë në misionet ISAF, të drejtuar nga NATO, në Afganistan, Althea në Bosnjë-Hercegovinë, "Liria e Irakut" në Irak, në operacionin "Active Endeavour" në Mesdhe, si dhe pjesëmarrjen me vëzhgues në Gjeorgji (UNOMIG).

Po kështu, do të rritim bashkëpunimin, në kuadër të Kartës së Adriatikut, për të realizuar angazhimet që kemi marrë në Konferencën e Tiranës më 24 tetor të vitit të kaluar për të forcuar sigurinë, stabilitetin dhe përparimin e rajonit, duke nxitur marrëdhënie më të ngushta dy dhe shumëpalëshe.

Ne mbështesim marrëveshjen e Presidentit Ahtisari për zgjidhjen e statusit final të Kosovës dhe besojmë se me kontributin e qytetarëve të Kosovës, të komunitetit ndërkombëtar dhe të vendeve të rajonit, ajo do të sigurojë paqe dhe stabilitet në Kosovë, në rajon dhe më gjerë.

Kuvendi i Shqipërisë ngarkon Komisionin e Sigurisë Kombëtare që të rrisë autoritetin e vet mbikëqyrës për të ndihmuar në realizimin e shpejtë të procesit të transformimit të thellë strukturor dhe të pajisjeve në Forcat tona të Armatosura, me pikësynim arritjen e standardeve të NATO-s: një ushtri tërësisht profesioniste, të vogël në numër, efikase, të mirëstërvitur, ndërvepruese me forcat e armatosura të aleatëve, për të qenë efikase në misionet e mbështetjes së paqes të NATO-s dhe të koalicioneve të vendeve demokratike.

21 mars 2007